



Viti 2013 mund te jetë viti me i erret ne historine e Tiranes. Bardheblute jane duke kaluar një moment te veshëtire dhe ne tabelen e klasifikimit gjenden te fundit dhe pa asnjë shprese shpetimi. 11 pike dhe një ndeshje e mbetur per kete vit nuk jepin asnjë mundesi që Tirana te largohet nga vendi i fundit ku qendron prej një muaji. Drejtuesit kane menduar te marrin disa lojtare ne muajin janar si perforsime por situata nuk duket aspak shpresedhenese per tifozet bardheblu që javet e fundit kane filluar te bejne trazira ne stadiume ne shenje proteste per situaten e krijuar tek Tirana e tyre. Ndeshjen e fundit te kampionatit per kete vit, Tirana do ta luaj te shtunen perballë Teutes.